



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

PROGRAMI: TEKNOLOGJI INFORMACIONI NË BIZNES DHE EKONOMI (BSc.)

Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit:	Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i parë i Bolonjës (Bachelor) BSc., Niveli i VI.
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Bachelor i Shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi (BSc.)
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):	04 (04.2 dhe 04.3) Program interdisciplinar studimi
Kohëzgjatja minimale e studimit:	Tre vite / 6 semestra
Forma e studimit:	Studime të rregullta
Numri i ECTS kredive:	Gjithsej 180 ECTS, për një vit 60 ECTS
Profili i programit akademik (specializimi):	Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi Bachelor i shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi u ofron studentëve një studim të nivelit hulumtues në lëmin e Informatikës së biznesit që është një nga fushat kryesore në të cilat varen ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha për rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të biznesit të tyre, si dhe për të fituar përparësi konkurruese në ekonominë e tregut. Studentët e aftësuar në këtë program do t'u ofrojnë mundësinë punëdhënësve të tyre që të arrijnë dhe të përcjellin ndryshime të suksesshme të biznesit duke prezantuar qasje të reja për përdorimin e teknologjisë dixhitale, për një proces të suksesshëm biznesi dhe optimizimin e modelit të biznesit. Meqenëse Informatika e Biznesit kombinon fushat e njohurive të biznesit, njohuritë e menaxhimit dhe aftësive shoqërore, si dhe përdorimin teknologjisë së informacionit në Biznes, Programi Bachelor i shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi synon që përmbushë nevojat e tregut me hulumtues dhe

	profesionist të kualifikuar në sferën e informatikës së zbatuar në të gjitha disiplinat e bizneseve të Kosovës në përgjithësi.
Rezultatet e pritshme të të nxënit:	Rezultatet e pritura në programin Bachelor në Teknologji Informatikë në Biznes dhe Ekonomi janë që Studenti pas përfundimit të programit është në gjendje të: - Analizon, zbërthen dhe paraqet matematikisht problemet nga jeta reale e biznesit (lendet që lidhen: matematika, statistika, algoritmet, programimi etj) - Krijon dhe përpunon të dhëna për nevojat e bizneseve (lendet që lidhen. Bazat e të dhënave, big data, sistemet e vendimmarrjes etj) - Projekton dhe administron rrjeta kompjuterike për nevojat e bizneseve (rrjeta kompjuterike, protokollet e rrjetave, teknologjia e internetit etj) - Krijon dhe përpunon modele të aplikuara në biznesin elektronik (tregtia elektronike, marketingu digital, financat digjitale, web design etj) - Kupton dhe përdor konceptet e biznesit, ekonomisë, etikës, dhe të drejtës (bazat e biznesit, kontabiliteti, financat HRM, menaxhimi i projekteve, marketingut, ndërmarrësi dhe inovacioni, menaxhimi i operacioneve, hyrje në ekonomi, biznesi ndërkombëtar, e drejta dhe etika në IT) - Hulumton, përpunon dhe prezanton të dhënat nga aktiviteti kërkimor (Shkrimi akademik, analiza statistikore, ekonometria, metodologjia e hartimit të diplomës, punimi i diplomës etj) - Komunikon me të gjithë aktet në sistemet e informacionit dhe proceset e biznesit (komunikimi në biznes)
Procedurat e mësimdhënies:	- Procesi mësimor mbahet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve dhe ushtrimeve laboratike (kabineti). Pothuajse të gjitha lëndët kanë edhe punë seminarike dhe kolokviume. Ligjëratat dhe ushtrimet mbahen në kohëzgjatje prej 45 minutash. Përveç formave të ndryshme aktive të mësimit përdoret sistemi i kolokviumeve, testimit dhe i ushtrimeve të obligueshme në mënyrë që përherë të ekzaminohet përparimi i studentëve gjatë studimeve. Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është në funksion të implementimit të programit dhe siguron arritjen e nivelit të nevojshëm të njohurive nga pjesa teorike dhe praktike. Në rastin konkret, ky raport është 50:50 dhe në disa raste edhe 60 me 40. Gjithashtu studentet kanë hapësirë që të shprehin njohuritë e përgjithshme në praktikë në kuadër të lëndëve përkatëse. Këto lëndë janë obligative dhe gjatë semestrit studentet janë të obliguar që të përfundojnë praktiken në institucione publike – private në mënyrë ligjore me të gjitha dokumentet e lëshuara nga Fakulteti i Biznesit,

	konkretisht nga QZHK. Metodologjia e mësimdhënies: - Ligjërata interaktive, prezantime në Power point; - Analiza dhe shembuj praktik; - Diskutime; - Ushtrime me shembuj të ndryshëm nga fusha të ndryshme të ekonomisë; - Detyrat do të prezantohen dhe diskutohen në klasë nga të gjithë studentët në frymën e një interaksioni produktiv, ku studentët do të mësojnë nga njeri tjetri me inputet e mësimdhënësit aty ku është e nevojshme.
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Të gjitha lëndët kanë punë seminarike dhe kolokviume, ndersa vlerësimi përfundimtar bëhet me anë të testimit me shkrim dhe gojor (Neni 104, 105, 106 statuti i UHZ). Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit (teste, seminare, pjesëmarrje, projekte, etj), si psh: - Vlerësimi i parë: 20 %, - Vlerësimi i dytë: 20%, - Detyrat ose angazhime tjera 10%, - Vijimi i rregullt 5%, - Provimi final 45%, - Totali 100%
Modulet /Lëndët (titujt):	Viti I 1. Teknologji e informacionit 2. Matematika I 3. Gjuhë angleze I 4. Bazat e kontabilitetit 5. Bazat e Menaxhimit të Biznesit 6. Teknologji të Internetit 7. Mikroekonomia 8. Biznesi Elektronik 9. Financat 10. Statistika dhe Probabiliteti Viti II 11. Informatikë biznesi 12. Financat digjitale / Fintech 13. Bazat e marketingut 14. Hyrje në baza të të dhënave 15. E drejta dhe Etika në IT 16. Sisteme informacioni të kontabilitetit 17. Menaxhimi i Projekteve 18. Shkrimi akademik 19. Lëndë opcionale (transfer ECTS kredi)

	20. Projektimi i bazave të dhënave 21. Hyrje në Rrjetat Kompjuterike 22. Menaxhimi i burimeve njerëzore 23. Makroekonomia 24. Bazat e Programimit 25. Komunikimi mobil në biznes 26. Ekonometria 27. Dizajni dhe grafika kompjuterike 28. Lëndë opcionale (transfer ECTS kredi) Viti III 29. Menaxhimi Financiar 30. Kriptografia dhe siguria kibernetike 31. Ndermarresia dhe Inovacioni 32. Marketingu Digjital 33. Virtualizimi dhe Cloud kompjutimi 34. Sistemet e informacionit te vendimarrjes 35. Interneti i gjërave (Internet of Things) 36. Lëndë opcionale (transfer ECTS kredi) 37. Taksat dhe Korporatat 38. Sisteme inteligjente multimediale 39. Internship / Punë praktike 40. Punimi i diplomës 41. Bazat e Kontabilitetit Financiar dhe Menaxherial 42. Tregjet financiare elektronike 43. Big Data 44. Ekonomiksi i Teknologjisë së Informacionit 45. Lëndë opcionale (transfer ECTS kredi)
Numri i vendeve të studimit:	120
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	1. Prof. asoc. Dr. Ylber Januzaj
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	6 profesor të rregullt, 8 profesor të asocuar, 12 profesor asistent, 4 asistent
Taksat e studimit:	Të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Studimet janë falas. Vërejtje: Në rast kur përsëritet viti, bëhet pagesa sipas Udhëzimit Administrativ MASHTI Nr.09/2021.
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	Pozicionet realiste të punës pas diplomimit: - Analist i të dhënave të biznesit (Business Data Analyst) - Specialist për Sisteme të Informacionit të Biznesit - Specialist për Transformim Digjital (Digital Transformation Officer)

- Menaxher ose Asistent për Projekte IT në Biznes
- Specialist për Marketing Digjital / E-commerce
- Fintech / Analist Financiar Digjital
- Specialist për Administrim të të Dhënave (Database Administrator / Data Officer)
- Asistent për Siguri të Informacionit (Information Security Assistant)
- Konsulent për IT në Biznes / Analist i Procesit të Biznesit
- Asistent Kërkimi ose Analist Ekonomik

Sektorët ku mund të punojë:

- Banka dhe institucione financiare (për Fintech, analiza, raportim digjital)
- Kompani tregtare / prodhuese (menaxhim informacioni, analiza tregu)
- Institucione publike dhe agjenci qeveritare (analizë ekonomike dhe IT)
- Kompani IT dhe Startup-e digjitale
- Agjenci marketingu digjital
- Organizata ndërkombëtare dhe konsulenca biznesi